



UNITED STATES
OF ADVENTURES
CAMP



Manuali i Prinderve




officially
recognized by:



Përmbajtjen e manualit

1. Rreth nesh
2. Historia
3. Stafi
4. Misioni dhe qëllimi Ynë,
5. Ambientet e kampit
6. Programi
7. Orari i kampit
8. Kompetenca gjuhësore
9. Çfarë të vishni
10. Noti/Pishina
11. Transporti i Kampit/ Transport Personal
12. Ushqimi
13. Shëndeti dhe Siguria
14. Sistemi i Komunikimit të Prindërve
15. Certifikimet
16. Procedura e regjistrimit
17. Pagesat- Pagesa javore dhe Rregullorja



Letër hyrëse

Përhëndetje prindër dhe fëmijë!

Dëshirojmë t'ju urojmë mirëseardhjen në United States of Adventures Summer Camp, një kamp që synon të sjelli risi, të edukojë, argëtojë dhe të jetë një mjedis i paqtë dhe i sigurt për fëmijën tuaj.

Ideja jonë për këtë kamp nisi nga puna dhe projektet tona të përbashkëta disa vjeçare. Ne morrëm dhe shqyrtuam cdo kërkesë të prindërve dhe kuptuam që me zhvillimin e brezave kampet verore në vendin tonë kishin nevojë për një ndryshim. Vendit tonë i mungonte një kamp ku çdo aktivitet kryhet për një qëllim edukativ. I mungonte një kamp i strukturuar ku fëmijët vendosen në sinkron me natyrën dhe mësojnë të kujdesen për miqësitë e tyre përtej botës teknologjike.

Ne jemi kujdesur për këtë kamp me shumë dashuri deri në detajet më të vogla duke filluar me logon e deri

te programi, dekori dhe ambjenti. Shpresojmë që përkujdesja që fëmijët tuaj do të kenë, duke përjetuar një verë të jashtëzakonshme të përcillet dhe te ju.

Me ndihmën e një stafi të kualifikuar, me ambientet tona të përshtatshme për cdo moshë dhe me prindër bashkëpunues, jemi të sigurt që fëmijët tuaj do të kalojnë një eksperiencë ndryshe e cila do i rrisi nga ana sociale dhe edukative.

Duam t'ju falenderojmë paraprakisht secilin prej jush për interesin tuaj dhe që na zgjodhët ne!

Shihemi në USA Camp. ,

Adela Masha (Administratore e Shkollës Wodrow Wilson International)

Megi Serjani (Young Engineers Albania CEO)




Rreth nesh

United States of Adventure Summer Camp është një kamp veror argëtues dhe edukativ. Ne synojmë që nëpërmjet programit tonë të aftësojmë kampistët për të qenë kreativë në situata të ndryshme, të jenë më pranë natyrës, të mësojnë shkencë në aspekt logjik dhe jo mekanik, të argëtohen dhe të nxisin miqësi të reja.

USA Summer Camp. do të jetë një kurrikulë prestigjioze e Young Engineers e kombinuar me një ambient dhe mjedis për të cilin jemi kujdesur deri në detaje.

Stafi ynë është trajnuar nga ekspertë të Young Engineers për metodologjinë e edukimit gjatë shkollave verore, komunikimi jashtë ambienteve të një klase, ofrimi i një mjedisi të sigurt dhe mirëkuptues dhe arritja e objektivave të çdo aktiviteti.

Çertifikimi që çdo kampist do të marrë në fund të eksperiencës me USA Camp. do të jetë nga Young Engineers në bashkëpunim me Harvard Graduate School of Education.



Historia



Kampi ynë vjen si një bashkëpunim i ndërthurur nga historia mbi 20 vjeçare e shkollës Wilson dhe risive të Young Engineers.

Shkolla Woodrow Wilson International është një nga pionerët e zhvillimit të kampeve verore në Shqipëri. Me më shumë se 20 vite eksperiencë, ata ishin ndër të parët që konceptuan kampet verore me aktivitete në fusha të ndryshme dhe pishinën. Kampi i shkollës Wilson ka treguar ndër vite që nuk zhgenjen kurrë në sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës tuaj. Këtë vit kampusi i kësaj shkolle do të shndërrohet çdo ditë në një “minishtet” ku çdo kampion do të shkojë në një udhëtim veror të paharrueshëm.

Young Engineers është një organizatë botërore ku kurrikula e Summer Camp ka mbi 5 vite që implementohet . Ne na bën shumë të lumtur që aktivitetet dhe eksperiencia që fëmijët tuaj do marrin do të zhvillohen paralelisht me shumë kampe verore Young Engineers duke filluar nga vende të rajonit si Maqedoni, Rumani e duke vazhduar në Angli apo Amerikë. United States of Adventures Summer Camp është kampi i parë

i plotë që Young Engineers sjell në Shqipëri e ne shpresojmë të kthehet në një traditë.

Ne mendojmë se simbioza e eksperiencës, stafit të përkushtuar dhe ambjenteve fantastike të shkollës Wilson me inovacionin dhe energjinë globale që kanë aktivitetet e Young Engineers do të jetë një sukses i plotë në të dhënit më të mirën për fëmijët tuaj.



Stafi



Stafi i Young Engineers do të përbëhet nga një ekip i strukturuar ku secili do të ketë rolin e tij që ky kamp të jetë një mjedis i ngrohtë, i sigurt dhe ku fëmijët tuaj do të jenë gjithmonë fokusi kryesor.


Trajnimi i stafit ka nisur online prej më shumë se një muaji ku janë prekur tema të ndryshme të edukimit dhe sjelljes nga ana e mësuesit dhe kordinatorëve të kampit. Pjesë e stafit do të jenë:

Drejtuesit e programit: drejtuesit e programit do të qëndrojnë me kohë të plotë çdo ditë. Do të kenë funksion mbikqyrës për stafin dhe do sigurohen që çdo aktivitet të kryhet në mënyrën e duhur dhe çdo problematikë të zgjidhet me shpejtësi.

Koordinatorët: koordinatorët e kampit do të jenë të ndarë për çdo grupmoshë. Ata do të sigurohen të jenë një mbështetje e parë për mësuesit dhe të sigurohen që fëmijët të jenë gjithmonë të përkujdesur. Çdo koordinator do të ketë një skedë për çdo fëmijë që i përket grupit të tij dhe do të pasqyrojnë te prindërit përshkrime të aktiviteteve dhe foto. Ata do të jenë përgjegjës dhe për transportin dhe vendosjen e fëmijëve në furgonat përkatës.

Mësuesit përgjegjës: çdo mësues do të ketë një grupmoshë sipas aftësive dhe trajnimit. Ata do të jenë përgjegjës për mbarëvajtjen e aktiviteteve, plotësimin e nevojave të fëmijëve, organizimit të ditës dhe shoqërimit në çdo mjedis të kampit.

Mësues specifike: pjesë e kampit do të jenë mësues specifikë për aktivitete apo klube të ndryshme si kërcimi, yoga, shkenca, anglisht, etj.





Mësues të sportit: mësuesit e sportit përveç se të udhëheqin aktivitetet sportive të kampit, do të jenë përgjegjës për pishinën dhe sigurinë në pishinë dhe disiplinën në kamp.

Sekretare: sekretarja e kampit do të bëjë të mundur përditësimin e përshkrimit të aktiviteteve, sygjerime dhe fotove në portalin e prindërve. Gjithashtu do jetë në gatishmëri për çdo kërkesë informacioni që mund të keni për fëmijën tuaj nëpërmjet numrit të telefonit dhe email.

Stafi i higjenës dhe ushqimit: Përveç stafit tonë në shërbim në kuzhinë apo të ofrimit të kushteve të higjenës, të dy këto sektorë do të mbikëqyren nga

një kordinator që do të përkujdeset për plotësimin e kushteve maksimale, alergjive mjedisore apo alergjive në ushqim.

Mjek: mjeku i shkollës do të jetë në gatishmëri për çdo të papritur apo komplikacion që fëmijët mund të kenë gjatë ditës.

Staf mbështetës: staf i trajnuar për mbarëvajtjen e përgjithshme të programit që mund të vijnë në ndihmë për këdo sipas nevojës.

Pas regjistrimit të fëmijës tuaj, do të merrni një komunikim nga mësuesi dhe kordinatori i grupit përkatës me shpjegime të mëtejshme për veten e tyre dhe mënyrën e zhvillimit të aktiviteteve.



Misioni dhe qëllimi Ynë

Misioni ynë është të edukojmë fëmijët dhe ti mundësojmë një eksperiencë të dobishme dhe argëtuese që do nxisi maturinë dhe krijmtarinë tek ta. Fëmijët do të sfidojnë veten dhe do mësojnë të jenë më të pavarur.

Qëllimi i këtij kampi është të nxisim aftësi të reja dhe talente që secili prej tyre mund ti ketë. Ne besojmë se angazhimi i tyre në fusha të ndryshme në një mjedis argëtues ka një impakt të madh në zhvillimin psikologjik të fëmijës.

OBJEKTIVAT:

- Zhvillimi i aftësive të nevojshme
- Edukim dhe argëtim
- Promovim i pavarësisë në të menduar dhe krijuar
- Stimulimi i miqësive dhe respekti ndaj tyre pavarësisht dallimeve apo ndryshimeve
- Angazhimi i fëmijëve intelektualisht
- Zhvillimi i konkurrencës të shëndetshme
- Zhvillimi i mendimit kritik dhe

vetë shprehinë

- Mësimi i vlerave dhe qëndrimeve të përshtatshme për moshën
- Mësimi i koncepteve të para për botën profesionale dhe profesioneve të ndryshme



Ambientet e kampit



U.S.A Summer Camp është një kamp i konceptuar në natyrë. Pas studimit dhe konsultimeve me psikologë dhe krijues të programit, sot të gjithë mendojnë që fëmijët po distancohen çdo ditë e më shumë nga natyra. Disa nga impaktet pozitive që kjo ripërqsasje sjell janë:
Aftësi më të mira leadershipi (udhëheqje)
Aftësi më të mira komunikimi
Vendosmëri më e madhe dhe vetëbesim
Përqëndrim më i lartë
Kultivimi i sjelljes pro natyrës
Edukimi me vlerat e ruajtjes së mjedisit që na rrethon

USA Summer Camp. do të zhvillohet në kampusin e shkollës Wilson. Të rrethuar nga gjelbërimi, fëmijët do të kalojnë orët e ditës në klasat tona “outdoors”. United States of Adventure Camp do të përfaqësojë një minishtet ku secila prej klasave tona në natyrë do të përfaqësojë një qytet ku do të zhvillohen një grup aktivitetesh. Nga qyteti i Van Gogh për artin dhe kraftet, Newton për shkencën dhe eksperimentet, Silicon Vaelly për qendrën e inovacionit dhe biznesit e deri te Wodrow Wilson për klubet e debatit dhe fjalës së lirë do të jenë vetëm disa prej tyre. Klasat tona në natyrë ose “miniqtetet” janë të përbëra nga tenda të ndryshme të dekoruara dhe me mjetet e nevojshme sipas tematikave përkatëse.

Gjithashtu fëmijët do të kenë dhe në ambientet e brendshme hapësira si : Hapësira e përbashkëta rekreative, Biblioteka, Qendra e lojërave dhe bisedave, Palestra e brendshme, etj.

GJITHASHTU PJESË E KAMPUSIT DO TË JENË:

Fushat e Sportit ku do të zhvillohen aktivitetet sportive dhe lojëra
Kopshti zoologjik brenda shkollës ku përfshihen shpendë dhe kafshë të ndryshme
Amfiteatri për vënien në skenë të shfaqjeve apo të shprehurit të vetes
Pishina me standarte të përshtatshme për përdorim nga fëmijë të grupmoshave të ndryshme
Hapësira të gjelbërta të rindërtuara për meditim, yoga, etj



Programi

Programi i USA Summer Camp. është i larmishëm dhe një program i ideuar nga ekspertë botërorë ku çdo fëmijë të gjejë veten dhe të ndihet i kuptuar dhe i aftë.

Programi është ideuar që çdo grupmoshë të ketë aktivitetet e tyre. Çdo ditë përmban deri në 8 aktivitete të mirëstrukturuara në objektiva dhe

mjete dhe të përshtatura në oraret e duhura.

Çdo ditë e USA Summer Camp. do të jetë e ndryshme. Kjo do të thotë që për plot 6 javë USA Summer Camp. do i çojë fëmijët në një udhëtim ku secili do të zbulojë më shumë për veten, do të fitojnë vetëbesim, do mësojnë dobitë e punës në grup e do marrin njohuri të vlefshme që do i shoqërojnë gjithmonë.



Më poshtë do të gjeni vetëm disa prej aktiviteteve të çdo jave:

GRUPMOSHA (5) 6-8

JAVA 1

GET TO KNOW EACH OTHER THROUGH GAMES
MORNING YOGA
SOLAR SYSTEM
PLAYGROUND SENSORY TRAIL
STORYTELLING
SUPERHERO DESIGN
GARDENING
SCIENCE EXPERIMENTS
ART AND CRAFTS - DRY PLANTS
SENSORY BIN PLAY
POOL
BIG BUILDERS AND ALGO PLAY: YOUNG ENGINEERS SCIENCE AND CODING
ENGLISH BOOK CLUB
TALENT SHOW

JAVA 3

MORNING STORYREADING
SCULPTURE AND CLAY
COOKING WITH GRANDMA: USE COOKING TO LEARN SCIENCE
UNDERWATER MARINE
MORNING MEDITATION
TREASURE CHEST IN ARTS AND CRAFTS
SALTWATER EXPERIMENTS
QUIZ AND WORKSHEET GAMES
THEMED SCRABBLES
SUGAR CRYSTALS
MOON SAND
THEATRE/PLAY
CONCENTRATION GAMES

JAVA 2

ANIMALS IN ARTS AND CRAFTS
ANIMALS SOCIALIZING AND KNOWLEDGE
OUTDOORS TWISTER
MORNING DANCE
ARCHITECT FOR A DAY
3D PAINTING
CANDY BINGO
LISTENING GAMES
THE MAZE
LEGO RABBIT
ENGLISH CLUB
BIG BUILDERS AND ALGO BUDDY-YOUNG ENGINEERS SCIENCE AND CODING
POOL
OLYMPIC GAMES

JAVA 4

SCAVANGERHUNT
ROCKET SCIENCE IN ARTS AND CRAFTS
FINGERPAINTING
BALLOON GAMES
MEDITATION AND YOGA
CAMPING
DAY TRIP
RAINBOW MILK IN SCIENCE
POOL
BIG BUILDERS AND ALGOBUDDY-YOUNG ENGINEERS SCIENCE AND CODING
ENGLISH CLUB
YOUNG ENGINEERS COMPETITION

**Më poshtë do të gjeni vetëm disa prej
aktiviteteve të çdo jave:**


GRUPMOSHA (5) 6-8

JAVA 5

ORIGAMI
MORNING ZUMBA AND MARTIAL ARTS
CINEMA
CRITICAL THINKING SITUATION BINGO
AN ASTRONAUT FOR A DAY
BIRD FEEDER
BUSSINES HUB FOR KIDS
CREATIVE WRITING
BIG BUILDERS AND ALGOBUDDY-
YOUNG ENGINEERS SCIENCE AND
CODING
POOL
LANGUAGES AND CULTURE DAY
ENGLISH CLUB
TABLE GAMES, SOCIALISING
POOL PARTY
TREASSURE HUNT

JAVA 6

MORNING YOGA
DANCE AND MARTIAL ARTS
SCIENCE EXPERIMENTS
MONOLOGUE AND SELF EXPRESSION
WATER GAMES
LEGO CATAPULT
INVENTOR FOR A DAY
OBSTACLE COURSE
ENGLISH CLUB
YOUNG ENGINEERS
FAVOURITE GAMES
GRADUATION DAY DECOR MAKING
MEMORY LANE-WHAT WE LEARNED IN
THE SUMMER CAMP



Më poshtë do të gjeni vetëm disa prej aktiviteteve të çdo jave:

GRUPMOSHA 9-11

JAVA 1

GET TO KNOW EACH OTHER
BALLOON TOWER
MOON CALCULATOR
CONTINUED DRAWING
WEATHER VANE
ANIMAL CHARADES
LEGO CATCH
SUPERHERO FOR A DAY
FRIENDSHIP GIFTS
GARDENING
LEGO CATCH
PAINTING TECHNIQUES
POOL
ROBOTICS AND CODING-YOUNG
ENGINEERS
ENGLISH CLUB
TALENT SHOW

JAVA 3

MORNING JOURNALING
PICK A STICK GAME
BUSSINES HUB
SCAVANGER HUNT
COOKING WITH GRANDMA: FUN, FOOD
AND SCIENCE
CHESS AND OTHER TABLE GAMES
METAL BALLS
ESCAPE ROOM
MARTIAL ARTS
CALIGRAPHY AND ORIGRAMI
POOL
ROBOTICS AND CODING- YOUNG
ENGINEERS
ENGLISH CLUB
FRENCH CLUB
THEATRE PLAY

JAVA 2

SOLAR OVEN
SCRABBLE
TIE DYE
MORNING MEDITATION
STORYTELLING JAR
QUIZ GAMES
MEMORY GAMES
SURPRISE CREATE BOX
GRASS HEAD
POOL
GERMAN CLUB
ENGLISH CLUB
ROBOTICS AND CODING-YOUNG
ENGINEERS
OLYMPIC GAMES

JAVA 4

LEGO WHEEL OF FORTUNE
POOL PARTY
TREASURE HUNT
MAZES
FOCUS GAMES
PROFESSIONS FOR A DAY
BUSSINES BOX OF SURPRISE
COMPETITION GAMES
SPORTS
POOL
ITALIAN LANGUAGE CLUB
ENGLISH CLUB
CAMPING
FIELD TRIP
YOUNG ENGINEERS COMPETITION

**Më poshtë do të gjeni vetëm disa prej
aktiviteteve të çdo jave:**

GRUPMOSHA 9-11

JAVA 5

HANGMAN
CREATE AN APP/VIDEO GAME
CAPTURE THE FLAG
TABLE GAMES
CINEMA
MAKE A HOLIDAY BOOK
TIME CAPSULE
SUMO WRESTLING WITH INFLATABLE
SUITS
OBSTACLE RACE
TEAM BUILDING ACTIVITIES
SPANISH LANGUAGE CLUB
POOL
ENGLISH BOOK CLUB
ROBOTICS AND CODING-YOUNG
ENGINEERS



JAVA 6

YOGA
JOURNALING
ASTRONOMY
TED TALKS
MAKE A MOVIE
PHOTOGRAPHY COURSE
DANCE
GAMES IN NATURE
MOMENTS IN CAMP PROJECT
GRADUATION CEREMONY
PREPARATIONS
POOL
ENGLISH CLUB PROJECT
ROBOTICS AND CODING-YOUNG
ENGINEERS EXHIBITION



Më poshtë do të gjeni vetëm disa prej aktiviteteve të çdo jave:

GRUPMOSHA 12-15

JAVA 1

GET TO KNOW EACH OTHER
MEDITATION
FUTURE CAREERS
AIR RAID
PAINTING STONES PATH/OBJECTS
CREATIVE HUB
WHAT COUNTRY/CITY AM I (CULTURE GAME)
ALASKAN BASEBALL
SPORTS
YOGA AND DANCE
BUSSINES HUB COURSE
POOL
ENGLISH CLUB
GALILEO TECHNIC/ROBOTICS
PROJECTS- YOUNG ENGINEERS
TALENT SHOW

JAVA 2

MEDITATION
SPRAYPAINTING
PHOTOGRAPHY COURSE
BLINDFOLD OBSTACLE COURSE-
TRUST YOUR FRIEND
EXPRESS YOURSELF IN CRAFTS
TWO TRUTHS AND A LIE
CINEMA
PLASTIC POLYMERS
EXTRACT DNA
SUMMER SCENERY PAINTING
GOLF
ENGLISH AND GERMAN CLUB
POOL
OLYMPIC GAMES

JAVA 3

JOURNALING
COOKING AND BAKE SALE
NEWSPAPER PROJECT
SCAVANGERHUNT
ESCAPE ROOM
APP PRESENTATION
SKILLS SETS: DIGITAL MARKETING
GRAPHIC DESIGN
SUMO SUIT
WATER SPORTS
BLOB TAG
PICNIC
THEATRE/PLAY
POOL
ENGLISH AND FRENCH CLUB
YOUNG ENGINEERS

JAVA 4

CIRCLE OF FRIENDSHIP
DEBATE CLUB
YOUTH EUROPEAN PARLAMENT
THE HOT SEAT
WOOD WORK
MEGA BUBBLE
CUP GAMES
BALLOON WALKING
POOL
ENGLISH AND ITALIAN CLUB
DAY TRIP
TED TALKS
FIELD TRIP CHALLENGES
YOUNG ENGINEERS COMPETITION

Më poshtë do të gjeni vetëm disa prej aktiviteteve të çdo jave:

GRUPMOSHA 12-15

JAVA 5

CALIGRAPHY AND ORIGAMI
BLINDFOLD DRAWING
THRIFT STORE CHALLENGE
MINIATURE ARCHITECTURE
TEAM BUILDING ACTIVITIES
SELF EXPRESSION CHALLENGES
MINUTE TO WIN IT GAMES
MARSHMALLOW WAR
COOKING CLASS
MAKE A JIGSAW PUZZLE
CREATE A VIDEO/VLOGGER FOR A DAY
BBQ BY THE POOL PARTY
POOL
ENGLISH AND SPANISH CLUB
YOUNG ENGINEERS
TABLE GAMES COMPETITION

Aktivitet e mësipërme janë vetëm disa nga aktivitetet e spikatura për cdo grupmoshë.

Ne kemi menduar dhe rubriken FUN FRIDAY- ku e premtja do të jetë një ditë që kampistët do ua dedikojnë një aktiviteti të përbashkët, të përgatitur gjatë javës dhe ku secili, do të mbulojë një rol të caktuar.

JAVA 1: TALENT SHOW

JAVA 2: OLYMPIC GAMES

JAVA 3: THEATRE

JAVA 4: YOUNG ENGINEERS
COMPETITION

JAVA 5: TABLE GAMES COMPETITION

JAVA 6: PREPARE FOR GRADUATION/
GRADUATING CEREMONY AND PARTY

Gjithashtu në realizimin e aktiviteteve do të kemi shpesh të ftuar nga bota e biznesit, teknologjisë, marketingut, fjalës së lirë apo gazetarisë, ekonomisë, etj.

JAVA 6

BUSSINESS HUB PROJECT
SCIENCE HUB PROEJCT
MEMORY LANE
TEAM BUILDING ACTIVITIES
VIDEOS/SHORT MOVIES
POOL
GRADUATION PREPARATIONS
FAVOURITE ACTIVITIES ON REPLAY
YOUNG ENGINEERS
FRIENDSHIP LETTERS
GIFTS IN CRAFTS



Orari i kampit

Oraret e kampit veror janë: **09:00- 15:00**
Kampi do të qëndrojë hapur nga e hëna në të premte.

KOMPETENCA GJUHËSORE

USA Summer Camp. do të zhvillohet në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht.

Për këtë arsye ne kemi vendosur që çdo grup të ketë një mësuese/trajnere dhe koordinatorë. Kjo do të lehtësojë bashkëveprimin mes fëmijëve nga kombësi të ndryshme.

Për fëmijët shqiptarë mendojmë që ky kamp përveç se do ti njohi me miq të rinj nga kultura të ndryshme, do të shërbejë gjithashtu në përmirësimin e aftësive të tyre në gjuhën angleze.

Gjithashtu English Club do të jetë një kurs argëtues për ta dhe për ti ndihmuar në bashkëbisedimin në gjuhën angleze. Pjesë e kampit do të jenë dhe ditë të ndryshme me aktivitete gjuhësore nga gjuhë të ndryshme.





Çfarë të vishni

Kampi Veror United Summer Camp do të ketë uniformën që cdo fëmijë do ti dhurohet në momentin që bëhet pjesë e kampit. (Edhe për ata që do të regjistrohen në afatin minimal prej një jave).

Uniforma do të përbëhet nga bluza me ngjyrë të vecantë për cdo grupmoshë. Ne mendojmë që uniforma jep ndjesi barazie dhe jo dallime duke krijuar nje ambjent komod që të gjithë fëmijët të respektojnë njeri-tjetrin dhe të miqësohen.

Gjithashtu përvec uniformës cdo fëmijë duhet të ketë në cantën e tij çdo ditë:

Peshqir

Set rrobash shtesë

Krem dielli

Shapka/Atlete

Tshirt shtesë

Nje xhaketë/triko në rast ndryshimi të motit apo temperaturave

Nuk lejohen në cantën e secilit : lodra nga jashtë(përveç rasteve të lodrave suport, të cilat fëmijët si sygjerim i një psikologu apo doktori i kanë të nevojshme), lodra apo mjete që rrezikojnë shëndetin apo sigurinë e fëmijëve të tjerë, ushqim nga jashtë, ilaçe apo mjete medicinale pa kontroll nga stafi, pajisje elektronike të ndryshme si ipad, nintendo apo telefon shtesë pa dijeninë e stafit.

Në rast të përkeqësimit të motit, të njëjtat ambjente që do krijohen në klasat tona në natyrë do të krijohen dhe në ambjentet e brendshme të shkollës. Kjo do të bëjë të

mundur zhvillimin pa ndërprerje të aktiviteteve të ndryshme të cilat janë në program.

Nëse dita me shi/mot të keq përkon me ditën ku fëmijët kanë aktivitete me ujë apo pishinë, do të zëvendësohet në ditën më të afërt që moti e lejon.

Në ditët me temperatura më të ulëta apo shi, sigurohuni që fëmijët të kenë pantallona/tuta të gjata dhe një xhaketë në cantë ose të veshur.



Noti/Pishina

Pishina do të jetë një aktivitet tjetër i kampit tonë. Pishina e shkollës Wilson ofron çdo parametër sigurie për çdo fëmijë. Ne i kemi përshtatur oraret e aktiviteteve në mënyre që çdo grupmoshë në momentin e pishinës të jetë vetëm me grupin përkatës. Kjo mundëson kontroll më të madh të fëmijëve dhe shmang komplikacione apo incidente.

Në momentin e pishinës, pranë çdo grupmoshe do të jenë mësuesit e

sportit përgjegjës për pishinën, 2 koordinatorë dhe mësuesi i grupit.

Stafi i kampit ka gjithashtu detyrën të kujdeset që çdo fëmijë të vendosi kremin kundër diellit, të ndërrojë rrobat pas pishinës, të thahen dhe të vishen.

Prindërit për çdo regjistrim do të pajisen me formular konsensusi për notin/pishinën që do përmbajë pikat e mëposhtme:

Leje për futjen në pishinë
Pyetje mbi nivelin e notit që fëmija di
Alergji të mundshme apo probleme që shkaktohen nga dielli apo elemente kimike të pishinave
Informacione të tjera që duhet të jemi në dijeni

Nëse prindërit nuk lejojnë futjen në pishinë të fëmijës, ky aktivitet do të zëvendësohet me një aktivitet tjetër po aq argëtues.



Transporti i Kampit



Transporti për në kampin veror do të sigurohet nga ne për në USA Summer Camp. Çdo mjet transporti do të operojë në një zonë të caktuar për të bërë të mundur grumbullimin sa më të shpejtë të fëmijëve. Pavarësisht kësaj, rradha e mbledhjes së fëmijëve do të jetë e paracaktuar sipas adresës. Mbledhja e fëmijëve do të nisi në orën 7:45 çdo ditë.

Transporti do të ketë një mësuese shoqëruese në marrjen dhe dorëzimin e fëmijëve.


Fëmijëve do tu përcaktohet një orar orientues për paraqitjen e furgonit pranë banesës, ku ardhja ditore mund të ndryshoj në tolerancën prej 2-3 minutave, por mësuesi ose i shoferi i furgonit do tu telefonojnë përpara se të afrohen në **adresën** tuaj.

Është e rëndësishme, që fëmija të jetë gati në orar, ku për shkak të trafikut ditor dhe zonës, mund të hasemi me vështirësi qëndrimi apo pritje.

Nëse transporti ju telefonon dhe ju nuk përgjigjeni në rastet e marrjes, duhet t'ju ritelefonojnë dhe 1 herë. Nëse përsëri nuk ka përgjigje, fëmija humbet mundësinë e transportit të ditës dhe do duhet të kujdesen prindërit për ardhjen e fëmijës në kamp.

Në rast mospërgjigje për marrjen e fëmijës, fëmija qëndron me mësuesen në furgon deri në momentin që ju përgjigjeni. Nëse përfundon shpërndarja e të gjithë fëmijëve, fëmija qëndron me mësuesen në një lokacion afër me adresën tuaj deri në momentin e përgjigjes apo marrjes nga prindi. (Për fëmijët në moshë të vogël)

Në rast se ju dëshironi të ndryshoni destinacionin e marrjes apo dorëzimit të fëmijës, duhet të telefononi një ditë para sekretarinë e kampit për ta konfirmuar.



Transport Personal

Nëse prindërit kujdesen vetë për transportin e fëmijës, duhet të bëjnë të mundur që fëmijët të mbërrinë dhe të ikin nga kampi në orën e caktuar.

Për mbërritjen, orari maksimal i mbërritjes është 10:30.
Për ikjen nga kampi, orari maksimal i marrjes së fëmijës është 15:30.

Në raste vonesash për arsye mjekësore apo personale, ju lutem të njoftoni sekretarinë më parë.

Nëse fëmija përdor transportin e kampit por për arsye vetjake ardhja apo marrja e fëmijës në ditë të caktuara do të bëhet nga vetë ju, duhet të telefononi sekretarinë për konfirmim paraprakisht.



Ushqimi



Ushqimi është një nga gjërat kryesore gjatë kampit veror. Ne jemi përpjekur të ofrojmë një menu të pasur me ushqime që fëmijët i pëlqejnë dhe janë të përshtatshme për temperaturën dhe stinën. Gjatë ditës fëmijët do të konsumojnë:

Mëngjesin : petulla, cornflakes, krepa, toste, qumësht,vezë,etj

Dreka:gjellë, mish,qofte,pulë,pasta,oriz,perime të ndryshme,pizza apo burger në ditë të caktuara,etj

Snack: biskota apo kek të bëra me sasi të ulëta sheqeri, fruta të stinës përgjatë ditës, pije si kakao me sasi të ulët sheqeri, akullore ,etj

Ujë të freskët do të ketë gjithmonë gjatë çdo ditë dhe lëngje frutash të freskët në ditë të caktuara.

Prindërit do të marrin me email menunë e çdo jave paraprakisht.

Nëse fëmijët kanë alergji ushqimore të ndryshme , do të bëhet i mundur ushqim i vecantë për këta fëmijë, gatuar ndaras nga të tjerët për të shmangur kontaminimin.

Nëse ka fëmijë që janë vegjetarianë, vegan etj, do të bëhet e mundur përshtatje e tyre në ushqim me një menu tjetër.

Nëse prindërit dëshirojnë që fëmijët të hanë gjithashtu diçka tjetër nga shtëpia,

do duhet të diskutoni paraprakisht me sekretarinë dhe ushqimi do ti jepet mësueses që e shoqëron gjatë transportit për tu ruajtur në kushtet e duhura dhe për tu dhënë në orarin e duhur.

Nuk lejohen që fëmijëve ti jepen me vete ushqime si patate të skuqura, burger apo fast food, ushqime me sheqer të paketuara si çokollata apo molto, ëmbëlsira si tortë apo akullore, pije me gaz apo pije me sheqer.



Shëndeti dhe Siguria



Të garantojmë një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt për fëmijët tuaj është prioritet për ne.

RREGULLORE PËR SHËNDETIN

Stafi i kampit do duhet të vihet në dijeni për çdo problem shëndetësor që fëmija ka.

Nëse ka ndonjë problem të deklaruar nga prindi dhe mjeku, stafi i kampit ka për detyrë ti japi fëmijës medikamentet e caktuara sipas udhëzimeve të prindit.

Këto medikamente duhet të mundësohen nga prindi.

Nëse fëmija ka shqetësime shëndetësore, mjeku i kampit bën një vizitë paraprake dhe përcakton vazhdimin e trajtimit për fëmijën.

Në rastin e një shqetësimi të shprehur nga fëmija, vihet në dijeni prindi dhe

vendoset së bashku me të nëse fëmija do të qëndrojë apo jo në kamp.

Tempratura 37,5 konsiderohet një temperaturë e lartë.

Në raste të një incidenti apo shqetësimi, fëmija merr ndihmën e parë nga mjeku dhe njoftohet prindi apo personi përgjegjës.

Në rast se fëmija ka nevojë për ndihmë të specializuar spitalore, stafi e transporton në spitalin më të afërt në rastin e pamundësisë së prindit.

RREGULLORE PËR SIGURINË

Fëmijët nuk duhet të kenë mjete që vënë në rrezik veten dhe shokët gjatë qëndrimit në kamp.

Në rast se një fëmijë bullizon apo i shkakton parehati fëmijëve të tjerë, njoftohet prindi.

Në rast të problemeve madhore si dhunë fizike apo psikologjike, fëmija përjashtohet nga kampi.

Në rast të mosbindjes dhe mungesë të disiplines, fëmija pezullohet deri në gjetjen e një dakordësie me prindin dhe psikologun e kampit.

Në rast të mospërshtatjes të fëmijës me aktivitetet apo llojin e kampit, vihet në dijeni prindi për gjetjen e një zgjidhje apo sygjerimit të një ambjenti më të përshtatshëm.

Ne mendojmë që së bashku me prindërit dhe psikologun e kampit, do të bëjmë të mundur që fëmijët të përshtaten me njëri-tjetrin dhe të gjejnë veten gjatë kësaj eksperience.



Sistemi i Komunikimit të Prindërve

Kampet verore janë një eksperiencë e re për fëmijët por edhe prindërit. Ne e mirëkuptojmë shqetësimin tuaj për përshtatjen, argëtimin por dhe sigurinë e fëmijëve tuaj. Për këtë arsye, USA Summer Camp ka vendosur të krijojë ura të reja komunikimi për qartësinë tuaj dhe lehtësimin e punës tonë.

Portali i prindit: në regjistrimin e fëmijës tuaj ju do të pajiseni me një QR Code që do ju mundësojë aksesin në një portal të veçantë i krijuar enkas për kampin veror. Pas logimit në portal, ju do të keni mundësi të shikoni fushat e mëposhtme:

Informacione të përgjithshme për ditën: Kjo rubrikë do të përmbajë informacione kryesore për ditën si aktivitetet, menunë ushqimore, kushtet e motit, etj

Realizmi i aktiviteve: Kjo rubrikë do të plotësohet gjatë ditës me shënime apo përshkrime të çdo aktiviteti që realizohet, fëmijët që spikatën, njohuri të marra, objektivat që u arritën, etj.
Rubrika do të plotësohet me shënimet e koordinatorëve dhe mësuesve.

Foto/Video: Në këtë rubrikë do të gjeni foto/video për çdo aktivitet.

Në përfundim të regjistrimit të fëmijës nga kampi, prindërve i dërgohen të gjitha foto/video të fëmijës gjatë qëndrimit në kamp.


Sekretaria: do të jetë e disponueshme për çdo njoftim që do duhet të bëni në bazë të pikave të sipërpërmendura gjatë këtij libri.

Ne mendojmë që krijimi i këtij portali do ju japi çdo informacion që duhet dhe kjo do i lejojë mësuesit dhe kordinatorët të përqëndrohen në realizimin e një kampi të jashtëzakonshëm për fëmijët tuaj.


Sekretaria do ju vijë në ndihmë që ne dhe prindërit të kemi një komunikim të menjëhershëm për çdo njoftim, problem apo shqetësim duke garantuar një bashkëpunim në të mirën e fëmijëve.



Certifikimet



Çdo fëmijë që regjistrohet gjatë USA Summer Camp, do të pajiset me certifikimin e Young Engineers Camp në bashkëpunim me Harvard Graduate School of Education dhe European Council.



Certifikimet do të jepen në fund të kampit në një ceremoni dhe festë ku mund të bashkohet çdo fëmijë që ka qenë pjesë e USA Summer Camp.

Nëse fëmijët nuk kanë mundësi të vijnë atë ditë, do të mund ti tërhiqni certifikimet në cdo moment gjatë muajve Gusht/Shtator/Tetor në sekretarinë e shkollës Wilson.

Procedura e regjistrimit

REGJISTRIMET JANË TË HAPURA PËR KËDO QË DËSHIRON TË JETË PJESË E KAMPIT.

Në numrat tanë të kontaktit/ adresën e email mund të njoftoni për regjistrimin dhe datat. (TË AFISHUARA DHE NË FUND TË KËTIJ LIBRI)

Në momentin e njoftimit të sekretarisë, do ju dërgohet një formular online që do duhet të plotësoni me të gjitha pyetjet dhe informacionet e nevojshme për fëmijën tuaj.

Ky formular do të jetë konfidencial dhe do të shërbejë dhe gjatë kampit për stafin në ardhjen në ndihmë të fëmijës tuaj.

VETËM NË MOMENTIN E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT FËMIJA QUHET I REGJISTRUAR. REGJISTRIMET MUND TË BËHEN NË CDO KOHË GJATË KOHËZGJATJES SË KAMPIT.



Pagesat

Pagesa javore dhe Rregullorja

Pagesa për United States of Adventure Camp është 15 000 ALL në javë.

Kjo pagesë përfshin transportin, ushqimin, uniformën, portalin e prindit dhe çdo aktivitet të zhvilluar.

Nëse ju keni më shumë se një fëmijë, secili prej tyre merr 10% zbritje.

Nëse ju sygjeroni dikë/disa fëmijë, merrni 10% zbritje ju dhe personi që ju sygjeroni. Mjafton që gjatë formularit të regjistrimit të vendosi në fushën REFERENCA emër atësi mbiemër të fëmijës tuaj.

Pagesa kryhet në momentin që plotësohet regjistrimi i fëmijës në kamp, në sekretarinë e shkollës Wilson.

Pagesa me bankë kryhet me të dhënat e mëposhtme: (?)

Për këdo që regjistrohet pas nisjes së kampit, pagesa kryhet menjëherë në momentin e regjistrimit.


KONTAKTE

YOUNG ENGINEERS:

✉ tiranacenter@youngengineers.org
☎ +355693669958

SHKOLLA WODROW WILSON INTERNATIONAL

🏠 Parku i Madh Kodrat e Liqenit, Tiranë 1001
🌐 www.wwi.edu.al
✉ info@wwi.edu.al
☎ +355 672 053 482
📷 [shkolla.woodrow.wilson](https://www.instagram.com/shkolla.woodrow.wilson)
📘 Shkolla Woodrow Wilson





UNITED STATES OF ADVENTURES CAMP



Manuali i Prinderve

officially recognized by:



HARVARD



GRADUATE SCHOOL OF EDUCATION